



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 60, datë 24.04.2019

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E NJË POZICIONI TË LIRË TË PËRKOHSHËM PËR TRANSFERIM NË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, dhe në kërkesën e kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, kërkesë e regjistruar me aktin nr. 206 prot., datë 15.02.2019,

V E N D O S I:

1. Të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Të autorizojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm lidhur me procedurën e transferimit të përkohshëm me dhe pa pëlqim të gjyqtarit, bazuar në përcaktimet e vendimit nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.
3. Të përcaktojë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe gjykatat e rretheve gjyqësor e Lezhë dhe Shkodër, si gjykata nga të cilat do të kryhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR